

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

07.11.2024  
Ora 16:34

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet “PER”-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj, znj. E. Demollari.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Në seancën e sotme publike kemi në rend dite për shqyrtim dy çështje:

Projektvendim “Mbi rregullat teknike të administrimit nëpërmjet PER-it të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Projekti i dytë ka të bëjë me “Miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nga jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Kush do ta relatojë?

**Znj. J. Josifi:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku janë të përcaktuara kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit dhe KAS-it. Kemi sjellë për shqyrtimin dhe miratimin tuaj projektvendimin “Për miratimin e rregullave teknike të administrimit, nëpërmjet “PER”-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Në mbështetje të nenit 24, pika 1 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohen kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit si dhe për faktin që KQZ-ja drejton, mbikëqyr dhe është përgjegjëse për procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave, që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe neni 25, pika 1, i Kodit Zgjedhor që parashikon se zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Duke u gjendur tashmë edhe për para faktit të miratimit të vendimit të Komisionit Rregullator me nr. 10 të datës 23.10.2024, i cili ka miratuar rregullat për regjistrimin si dhe hartimin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, proces i cili ndodh në Platformën Elektronike të Regjistrimit, përpara jush kemi përcjellë këtë projektvendim. Projektvendimi është i organizuar sikundër e dispononi, në katër krerë. Shkurtimisht po përpiqem të jap përmbledhjen për secilin prej krerëve. Në Kreun I të projektvendimit parashikohen rregulla të përgjithshme të përcaktuara në Ligj sa i takon shfaqjes së vullnetit të zgjedhësve nga jashtë vendit për t’u regjistruar në listën e zgjedhësve dhe për ta ushtruar këtë të drejtë. Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve sikurse ju citova, janë ato të përcaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator. Në kreun II, parashikohen rregullat e posaçme tekniko-proceduriale që lidhen me krijimin, administrimin, dhe funksionimin e “PER”, si dhe rregullat teknike për shqyrtimin e kërkesave që do të paraqesin këta zgjedhës në “PER”. Në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

zbatim të kuadrit rregullator në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në Republikën e Shqipërisë, kemi parashikuar se të gjitha të dhënat që kjo platformë do të administrojë, do të duhet të mbeten në pajisjet e përdoruesve fundorë, ashtu sikurse dhe në qendrën e të dhënave të KQZ, dhe ato do të përpunohen në përputhje me kuadrin ligjor të përmendur. Kjo platformë do të jetë e organizuar në dy komponentë, të cilët do të duhet të sigurojnë, të dy kahët, një proces të sigurt dhe të besueshëm për të menaxhuar kërkesat për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit. Komponenti i parë është ai i regjistrimit, përmes së cilës zgjedhësi bën kërkesën për regjistrim duke verifikuar së pari identitetin e tij. Komponenti i dytë është ai i back office, siç e quajmë ne, ose moduli i shqyrtimit të kërkesave, përmes së cilës administrata e KQZ shqyrton dhe verifikon informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga zgjedhësi. Në lidhje me funksionalitetin e “PER”, ne kemi listuar një sërë kërkesash teknike minimale që kjo platformë do të duhet të plotësojë. Unë nuk po ndalem pikë për pikë. Vijon Kreu III i projektaktit, duke përcaktuar rregullat në lidhje me mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe auditimin e platformës, ku parashikohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi, për sa i takon krijimit të sistemeve të teknologjisë të reja, duhet të parashikojë dhe hartojë marrëveshje kontraktuale për nivelin e shërbimit, për një kohëzgjatje jo më të shkurtër se dy vjet thotë legjislacioni në fuqi në rastin e sistemeve të reja. Për të siguruar transparencë po edhe qasje të të gjitha palëve, ndaj kësaj platforme, ju njihet e drejta: partive politike, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesve të shteteve të huaja të akredituara në Shqipëri, si dhe të medias, që të njihen me të gjitha elementët dhe karakteristikat teknike të kësaj platforme. Veçanërisht kjo gjatë proceseve: të testimit paraprak operacional, kontrollit apo auditimit të platformës. KQZ angazhohet që t’i njoftojë në kohë të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

gjithë palët e sipërpërmendura, për të marrë pjesë në këto këqyrje, si dhe t'u vërë në dispozicion paraprakisht të gjithë dokumentacionin teknik të nevojshëm. KQZ gjithashtu do të duhet, që me kërkesë të partive politike, ose kryesisht, mundëson auditim të pavarur të kësaj platforme nga subjekte të specializuara në çdo fazë të këtij projekti. Ky projektvendim është bashkërenduar me të gjithë palët e interesuara. Mendim me shkrim ka përcjellë zonja Anila Smorgrav (Hyka), përfaqësuese e Këshillit Kordinues të Diasporës. Ka qenë në fakt një kontribut konkret në tekstin e këtij projektvendimi. Për sa më sipër të gjitha sugjerimet e zonjës Smorgrav janë reflektuar në projektvendim. Gjithashtu Lëvizja “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, ka konfirmuar marrjen, konsultimin, dhe nuk ka pasur komente shtesë përpos atyre të bëra që në krye të herës për rregullat e regjistrimit për këtë projektvendim. Për sa më sipër citova, brenda kompetencave tuaj, në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor ju propozojmë për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet “PER”-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit Jona! Një gjë që ka rëndësi të evidentohet është fakti që ky projektakt është konsultuar me të gjitha grupet e interesit dhe ata të cilët kanë paraqitur komente dhe mendime, janë të reflektuara të gjitha në draftin final.

**Znj. J. Josifi:** Po, po! Kështu është.


**Z. I. Celibashi:** Kur flas për grupet e interesit, kam parasysh dhe partitë politike. Projektakti është përcjellë për mendim dhe konsultim partive politike dhe nuk ka pasur asnjë koment apo vërejtje prej tyre në lidhje me këtë draft.

**Znj. J. Josifi:** Jo, jo, nuk ka pasur.

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëhere, dakord, faleminderit!

Miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar për shqyrtim! **Vendimi nr. 194**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

**07.11.2024  
Ora 16:42**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nga jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj, znj. E. Demollari.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me “Miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nga jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”. Kush do ta relatojë, Elona?

**Znj. E. Demollari:** Përshëndetje! Po Kryetar! Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2, të ligjit nr.10019 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria e Votimit nga Jashtë ka përfunduar programin për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve nga jashtë vendit. Po paraqes një përmbledhje të shkurtër shpjeguese për sa i përket projektaktit. Programi ka si qëllim dhe objektiv kryesor edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve nga jashtë vendit për sa i takon zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025. Në këtë program përcaktohen hapa konkretë për realizimin e objektivave dhe gjithashtu

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

ky program, reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin zgjedhor të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve nga jashtë është ndër komponentët kryesore garantues për arritjen e standardeve të synuara. Programi për edukimin dhe informimin e zgjedhësve nga jashtë vendit është i ndarë në pesë krerë kryesore dhe përfshin të gjithë zgjedhësit nga jashtë, duke informuar këtë kategori në lidhje me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor duke nisur nga informimi si fillim për krijimin e mundësisë pra, për dheniende mundësisë së atyre që për herë të parë do të mund të votojnë. Më pas mbi rregullat e regjistrimit dhe familjarizimi me platformën PER tek e cila ato duhet të bëjnë regjistrimin. Pasi është kryer me sukses regjistrimi, më pas kemi verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, dhe më pas do të njihen me dërgimin e fletës së votimit dhe çdo materiali tjetër udhëzues nga KQZ tek votuesi. Plotësimi korrekt i fletës së votimit, në mënyrë që vota e tyre të vlerësohet dhe gjithashtu dhe dërgimin në kohë mbrapsht të fletës së votimit dhe po në këtë objektiv do të orientohen dhe do të informohen përsa i përket numërimit dhe vlerësimin e votave të ardhura nga zgjedhësit nga jashtë vendit. Të gjitha të dhënat personale të zgjedhësve nga jashtë vendit do të ruhen në zbatim të Ligjit Nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Përsa i përket zbatimit të këtij programi patjetër që luajnë një rol kryesor edhe bashkëpunorët që kanë si fushë interesi dhe kotribuojnë në këtë fushë dhe si audiencë e synuar e këtij programi do të jetë çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend 2025. Ashtu si e përmenda dhe më sipër programi përbëhet nga pesë objektiva kryesore. Në pjesën e parë është informimi kryesisht dhe më pas edukimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Njohja e tyre me ndryshimet në Kodin Zgjedhor të cilët bëjnë tashmë të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

mundur votimin e shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë vendit ditën e votimeve dhe pas daljes së dekretit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend, do të shpërndahet informacioni për zgjedhësit nga jashtë vendit për ndergjegjësimin dhe sensibilizimin e kësaj kategorie për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese. Pjesa e dytë janë “Rregullat e regjistrimit”, familjarizimi i tyre me Platformën Elektronike të Regjistrimit “PER”, sepse patjetër që një zgjedhës që dëshiron të votojë nga jashtë vendit duhet të paraqesë një kërkesë në mënyrë individuale në Platformën “PER”. I kemi saktësuar dhe qartësuar se si mund të aksesohet platforma “PER” e cila mund të aksesohet si në smartphonë por edhe në web nga laptopi, tableti dhe kompjuteri. Përsa i përket këtij objektivi fokusi është në familjarizimin me “PER”, afatet për regjistrim, të dhënat për dokumentacionin e kërkuar për deklarin e adresës jashtë vendit. Pjesa e tretë, lidhet me verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve, afatet se kur mund të verifikojnë dhe të kontrollojnë emrin e tyre dhe gjithashtu afatet se kur mund të bëhet një rregullim. Pjesa e katërt lidhet me plotësimin korrekt të fletës së votimit dhe më pas dërgimin e fletës së votimit nga ana e KQZ-së dhe pasi është plotësuar fleta e votimit, dërgimi mbrapsht i fletës së votimit në KQZ nëpërmjet shërbimit postar. Pjesa e pestë është se si do të administrohet fleta e tyre e votimit, si do të numërohet dhe llogaritja në tabelën e rezultateve. Patjetër që ky program ka dhe sfidat e veta, disa nga sfidat që po përmend janë: implementimi për herë të parë i këtij procesi mbart një sfidë në vetvehte në lidhje për përmbushjen e objektivave. Përfshirja në këtë fushatë ndergjegjësimi i një numri sa më të madh qytetarësh, sepse në bazë të të dhënave zyrtare, zgjedhësit që ndodhen me banim jashtë vendit janë të shumtë në numër, por dhe më një shpërndarje gjeografike të gjerë, ç’ka e bën përfshirjen e tyre në zgjedhje një sfidë të shumëfishtë. Duke marrë në konsideratë afatet tejet të ngushta ligjore/kohore, që lidhen me përmbajtjen e fletës së votimit, prodhimin e saj,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

dërgimin tek zgjedhësi dhe kthimin mbrapsht deri në ditën e zgjedhjeve, zbatimi i këtij programi është sfidë për KQZ-në, sepse ekziston risku për të mos marrë mbrapsht në kohë fletën e votimit. Gjithashtu dhe afatet e ngushta kohore për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor janë një tjetër sfidë. Në datën 29 tetor ky projektvendim ju është dërguar për konsultim publik nëpërmjet emailit përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të organizatës së diasporës dhe organizatave të shoqërisë civile vendase, duke lënë në dispozicion një afat për dërgimin e sugjerimeve deri në datën 1 nëntor dhe nuk ka pasur asnjë koment lidhur me projektvendimin. Përsa më sipër, propozojmë për shqyrtim dhe miratim këtë projektvendim.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit Elona! Do të duhet ta themi në fakt që është bërë një punë goxha e mira për sa i përket këtij aspekti përgatitor të votimit nga jashtë edhe pse koha ka qenë mjaft e ngushtë për ta përgatitur këtë dokument. Mendoj se ka rrokur të gjithë gamën e aspekteve të votimit nga jashtë ky koment i çështjeve që kanë të bëjnë më edukimin dhe informimin e zgjedhësve, ndaj do të duhet të merrni të gjitha falenderimet si sektor, por dhe si drejtori për çfarë është bërë në lidhje me këtë aspekt shumë të rëndësishëm të procesit të votimit nga jashtë. Është më rëndësi që ta themi që ky dokument është konsultuar gjerësisht edhe më përfaqësues të grupeve të ndryshëm të interesit, organizata të shoqërisë civile si ato që operojnë brenda vendit, ashtu dhe më ato që përfaqësojnë diasporën, po kështu dhe nga partitë politike. Natyrisht që më rëndësi mbetet zbatimi i këtij programi. Është e rëndësishme në fakt që për votimin nga jashtë programin e edukimit dhe të informimit e kemi ndarë nga ai për votuesit brenda vendit për të gjitha ato arsye të objektivitetit që na bënë të vendosim për ta ndarë për ta pasur në mënyrë të posaçmë një program për votuesit nga jashtë. Nga sa kuptova nga relatimi juaj, janë të përfshira

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionërit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 07.11.2024*

për aq sa ka qenë rasti, të gjitha mendimet dhe opinionet e grupeve të ndryshme të interesit në këtë program. Gjithësesi edhe në vijim, çfarë mbetet për të shtuar në këtë program, ne do ta shtojmë sidomos nga kontaktet që tani e në vijim, do të kemi më përfaqësues të votuesve që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Mund të lindë nevoja për ta pasuruar në përmbajtje, në formë të ekzekutimit, të aspekteve të këtij programi. Mirë atëhere, miratojmë dhe këtë projektvendim, sipas draftit të paraqitur. Çështje të tjera nuk kemi në rendin e ditës, faleminderit dhe ditë të mbarë të gjithëve!

**Vendimi nr. 193**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

